

VENDIM
Nr. 291, datë 19.5.2021

**PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E MIRATUAR PËR VITIN 2021, PËR
MINISTRINË E FINANCIVE DHE EKONOMISË, PËR FINANCIMIN E
PROJEKTIT “PËRMIRËSIMI I MODULIT TË MENAXHIMIT TË KONTROLLIT
TË FATURIMIT”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të neneve 5 e 45, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 17, të ligjit nr. 137/2020, “Për buxhetin e vitit 2021”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, në buxhetin e miratuar për vitin 2021, në zërin “Shpenzime kapitale me financim të brendshëm”, llogaria ekonomike 231, në programin buxhetor 01140 “Menaxhimi i të ardhurave tatimore”, i shtohet fondi prej 220 858 088 (dyqind e njëzet milionë e tetëqind e pesëdhjetë e tetë mijë e tetëdhjetë e tetë) lekësh, për projektin “Përmirësimi i modulit të menaxhimit të kontrollit të faturimit”.

2. Efekti financiar, i përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, përballohet nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit, miratuar për vitin 2021.

3. Ngarkohet Ministria e Financave dhe Ekonomisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe